



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Office of the Minister

Datë: 26/10/2021

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr 7/01 Mars 2019), sipas Nenit 4 të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.4) si dhe pika 10.4 dhe 10.5 e Shtojcës 1 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Me qëllim të adresimit të rekomandimeve nga raportet e Zyres Kombëtare të Auditorit (2019-2020), ngritjes së standardeve të zbatimit legjislativ e profesional në trajtimin e çështjeve administrative, formohet grupi punues ministror për, vlerësim profesional të procesit të lëshimit të akteve administrative nga sektori ujërave, mjedisit dhe ndërtimit të periudhës 2019-2021, në këtë përbërje:

- 1.1. **Shiqeri Dërmaku**, Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave, kryesues;
- 1.2. **Lindita Sopa**, Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave, anëtare
- 1.3. **Lindita Morina**, Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave, anëtare
- 1.4. **Fidan Bilalli**, Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore, anëtar;
- 1.5. **Fatlije Buza**, Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore, anëtare;
- 1.6. **Mevlane Kuka**, Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore, anëtare;
- 1.7. **Fisnike Kelmendi**, Departamenti ligjor, anëtare;
- 1.8. **Arben Ajazi**, Departamenti i Planifikimit, Ndërtimit dhe Banimimit, anëtar;
- 1.9. **Tringa Gjokolli**, Inspektorati i MNUNPH, anëtare.

2. Grupi Punues ka për detyrë që, lëndët e përzgjedhura administrative për vlerësim, sipas kritereve të legjislacionit material e procedural përkatës, standardeve dhe rregullave profesionale të pranueshme, të vlerësoj lëshimin e akteve administrative: Kushteve Ujore, Pëlqimeve Ujore, Lejeve Ujore, Pëlqimeve Mjedisore, Lejeve Mjedisore, Kushteve Ndërtimore, Lejeve Ndërtimore dhe Certifikatave të Përdorimit të periudhës 3 vjeçare (2019-2021) të lëshimit.
3. Grupi punues në harmoni me dispozitat rregullative të bashkëpunimit ndërinstitucional konsultohet me institucionet dhe njësitë administrative përkatëse/ relevante, si dhe sipas nevojës mund të angazhojë konsulentë/ekspert të jashtëm.
4. Grupi punues, në fund të procesit vlerësues, harton raport standard të strukturuar, përfshirë gjetjet, konkluzionet e rekomandime, të cilin e dorëzon përmes protokollit në Ministri deri me 15.02.2022.
5. Grupi punues për punën e vetë i raporton Ministrit të MMPHI
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Liburn ALIU

*Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit
Hapësinor dhe Infrastrukturës*

I'u dërgohet:

- Zyrës së Ministrit
- Zyreve të Zëvendësministrave
- Sekretarit të Përgjithshëm
- Anëtarëve të Grupit Punues
- Departamenteve përkatëse
- Arkivit të Ministrisë